



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 444/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të mosfunksionimit të baterive fluroscente, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet poshtë ankesa si e palejuar e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet më datë 12.12.2010 në shkollën fillore “Migjeni” QV 1102 dhe në Shkollën fillore “Fazli Grajqevci” QV 1103B se nuk kanë funksionuar bateritë fluroscente, siç thekson parashtresuesi i ankesës në këtë rast është bërë shkelje e nenit 7 paragrafi 1 pika (a) e LZP-së.

Parashtresuesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, parasheh:

59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji.

Përgjegjësit dhe Funkcionet e KQZ-së

Neni 64 i LZP-së parasheh:

64.1 KQZ-ja është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6 paragrafi 4 parasheh:

Panelet vendim-marrëse mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie .

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e palejuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë nuk janë nën juridiksionin e PZAP-it, duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 444/2010 më datën 13.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**

